

VENDIM
Nr. 558, datë 3.7.2013

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 997, DATË 10.12.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË PUNONJËSVE QË DËRGOHEN ME SHËRBIM JASHTË
QENDRËS SË PUNËS, BRENDA VENDIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/1 të kreut III të vendimit nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

“2/2. Përfshihen nga pika III-1 edhe anëtarët e Kolegjit Zgjedhor, kur ushtrojnë veprimtarinë pranë këtij kolegji gjatë periudhës së zgjedhjeve parlamentare apo vendore. Në këto raste, këta punonjës trajtohen sipas pikës III-3 të këtij vendimi.”.

2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha